



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10 / 16 gusht 2010), nenit 4 të Ligjit 05/L -116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Ligjin Nr. 04/L-168, nenit 9, nenit 16 paragrafi 3, dhe nenit 21 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale në Kosovë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/8 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 23 shkurt 2017 miratoi si në vijim:

## **Rregullore mbi Investimet e Mjeteve Pensionale**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe Fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj Rregullore është të specifikojë kushtet dhe parimet e investimit të mjeteve pensionale në pajtim me Ligjin nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës.
2. Kjo Rregullore do të zbatohet për Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit, dhe Pensionet Plotësuese Individuale më tej (Fondi/et Pensional/e).

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termet në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e definuar në nenin 1 të Ligjit nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës dhe Ligjit nr.04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (më tej Ligji për Fondet Pensionale) ose/dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje;
  - 1.1. **Menaxhuesi i mjeteve** - nënkupton një fiduciar (i besuar) i cili është person juridik i licencuar nga BQK-ja ose nga ndonjë organ tjetër rregullues i tregut të kapitalit në Kosovë (ose trashëguesi i tij) ose nga një organ i tregjeve të kapitalit të shteteve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik që investon apo i menaxhon mjetet ose siguron këshilla lidhur me investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për një Fond pensional plotësues të punëdhënësit ose për një Fond plotësues individual në bazë të marrëveshjes për menaxhimin e mjeteve.
  - 1.2. **“Bordi i Drejtorëve”** nënkupton organin më të lartë drejtues të fondit pensional.

- 1.3. **“Deklarata e parimeve të investimit”** - nënkupton politikën investuese dhe objektivat e zhvillimit të investimeve të përshtatura nga Fondi Pensional për investimin e mjeteve të pensioneve, e cila duhet të jetë në pajtim me Ligjin dhe rregulloret e BQK-së për pensione dhe me direktivat e investimit.
- 1.4. **“Direktivat e Investimit”** nënkupton urdhrat dhe udhëzimet e bëra nga Fondi Pensional për menaxherin/ët e mjeteve që specifikojnë termet, kushtet dhe mënyrën e investimit të mjeteve të pensioneve në pajtim me deklaratën e parimeve të investimit.
- 1.5. **“Instrument për Investime të Hapura”** nënkupton investim përmes subjekteve të organizuara që veprojnë si kompani investuese dhe të cilët janë të autorizuar të emetojnë numër të pakufizuar të aksioneve të kapitalit (në njësi të pjesshme apo të plota) duke paraqitur pronësi të barabartë proporcionale në subjektet e tilla nga aksionari apo polisave të sigurimit ku pasuria kryesore grumbullohet për qëllime investuese. Kjo shprehje përfshin fondet reciproke, fondet investuese, fondet e njësisë, polisat e sigurimit dhe mjetet tjera investuese, të cilët veprojnë në bazë të grumbullimit.
- 1.6. **“OBZHE”** nënkupton Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.
- 1.7. **“Palët e Ndërlidhura me Fondin Pensional”** nënkupton:
  - 1.7.1. anëtarët e bordit drejtues të fondit pensional;
  - 1.7.2. menaxhuesin i mjeteve të fondit pensional;
  - 1.7.3. mbajtësi i mjeteve të pensioneve;
  - 1.7.4. çdo person që është person i ndërlidhur me personat e përcaktuar në pikat 1.7.1), 1.7.2) dhe 1.7.3) më lartë.
- 1.8. **“Letrat me vlerë”** nënkupton, investimet në portofoliot e ekuiteteve, investimet në obligacione, borxhet ose obligimet tjera dhe të gjitha llojet tjera të investimeve të lejuara sipas Ligjit për Fondet Pensionale dhe kësaj rregullore.

### **Neni 3**

#### **Kushtet për investimet e mjeteve të pensioneve**

1. Fondi Pensional duhet të investojë mjetet pensionale vetëm në klasat e lejuara të investimeve të përcaktuar sipas Ligjit për Fondet Pensionale dhe kësaj rregullore, ose në para të gatshme tek mbajtësi apo në para të gatshme dhe depozita bankare në shumën që është e nevojshme dhe arsyeshme për të zhvilluar aktivitetin e tij.
2. Lejueshmëria e investimit do të përcaktohet në kohën e bërjes apo blerjes së tij. Nëse përcaktimi i lejueshmërisë bazohet në shumë, kufizimi bazohet në shumën totale të mjeteve të investuara në datën e vlerësimit që është raportuar në BQK.
3. Investimet e mjeteve të pensioneve duhet të jenë në pajtim me deklaratën e parimeve të investimit dhe me direktivat e investimit të lëshuara nga Fondi Pensional në pajtim me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale dhe kësaj rregullore.

4. Fondi pensional duhet të dorëzojë në BQK së bashku me raportet tremujore dhe vjetore, dokumentin përmes së cilit vërtetohet se të gjitha mjetet pensionale të investuara janë në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara me Ligjin për Fondet Pensionale, më këtë rregullore, deklaratën e parimeve të investimit dhe direktivat e investimit të lëshuara nga fondi pensional.
5. Mjetet e fondeve pensionale do të investohen sipas kushteve në vijim:
  - 5.1. Përpjesëtimi maksimal i letrave me vlerë të cilitdo emetues të vetëm, duke përfshirë personat e tij të anëtarësuar që mund t'i mbajë Fondi Pensional, është pesë përqind (5%) për aksione dhe tridhjetë përqind (30%) për obligacione. Asnjë kufizim i tillë nuk do të aplikohet për Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës.
  - 5.2. Përpjesëtimi maksimal i mjeteve të tërësishme të pensionit, që mund të investohen në mjetet e një emetuesi, duke përfshirë llogaritjen e mjeteve të personave të ndërlidhur, do të zbatohet në pajtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 05/L-116 për Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 Për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Ligjin Nr. 04/L-168.
6. BQK përmes ndryshimit të kësaj rregullore, mund të përcaktojë kohë pas kohe vlerat minimale të investimit për çdo klasë të mjeteve.

#### **Neni 4**

##### **Investimet e lejuara të mjeteve pensionale**

1. Mjetet pensionale mund të investohen vetëm në klasat ndërkombëtare si në vijim:
  - 1.1. Fondet monetare, duke përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat në banka që janë licencuar nga një organ rregullator bankar i shtetit që është anëtar i OBZHE-s dhe të cilat nuk janë nën masa të dhunshme ose licenca e tyre nuk i nënshtrohet pezullimit;
  - 1.2. Letrat me vlerë të emetuara nga ndonjë shtet anëtar i OBZHE-s;
  - 1.3. Letrat me vlerë të emetuara nga qeveritë në shtetet anëtare të OBZHE-s në masën që e garanton shteti përkatës;
  - 1.4. Letrat me vlerë të regjistruara në rregullatorin e tregjeve të kapitalit të cilitdo shtet anëtar i OBZHE-s me qëllim të përfshirjes së tyre në një ofertë publike, me kusht që këto letra me vlerë të figurojnë në bursën që i nënshtrohet mbikëqyrjes së rregullatorit të tregjeve të kapitalit;
  - 1.5. Fondet e përbashkëta dhe fondet e investimeve, që janë subjekt i miratimit në shtetin e themelimit, shtet ky që është anëtar i OBZHE-s.
2. Mjetet pensionale mund të investohen vetëm në klasat e mjeteve si në vijim:
  - 2.1. Fondet monetare, duke përfshirë llogarit bankare dhe depozitat e bankave të licencuara nga BQK-ja, por që nuk janë nën masa të dhunshme dhe që nuk i nënshtrohen pezullimit të licencës së tyre;

- 2.2. Letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës;
- 2.3. Letrat me vlerë të ndërmarrjeve (duke përfshirë veçmas stoqet dhe obligacionet) të regjistruara në rregullatorin e tregjeve të kapitalit të Kosovës dhe të plasuar përmes ofertës publike, me kusht që letrat e tilla me vlerë të jenë kuotuar në bursën e licencuar të letrave me vlerë në Kosovë ose në ndonjë juridiksion tjetër të shtetit anëtar të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), varësisht nga mbikëqyrja e rregullatorit në fuqi të tregjeve të kapitalit dhe;
- 2.4. Fondet e përbashkëta dhe të investimeve varësisht nga miratimi i rregullatorit në Kosovë.

## **Neni 5**

### **Investimet e ndaluara të mjeteve pensionale**

1. Mjetet pensionale nuk mund të investohen në klasat e mjeteve si në vijim:
  - 1.1. instrumentet e letrave me vlerë që nuk janë të regjistruara ose publikisht që nuk janë të tregtuara; mjetet që nuk mund të tjetërsohen me ligj;
  - 1.2. instrumentet e letrave me vlerë, opsionet, transaksionet me afat, kontratat paraprake dhe kontratat e tjera përkitazi me letrat me vlerë dhe mjetet e tjera financiare, me përjashtim që letrat e prejardhura me vlerë mund të përdoren si strategji mbrojtëse për zvogëlimin e rrezikut, me kusht që Fondi të mos ketë pozicion të pambuluar të shitjes;
  - 1.3. pasurinë e paluajtshme ose fondet fizike të paregjistruara në tregjet e organizuara, për të cilat vlerësimi është i pasigurt duke përfshirë veprat e artit antik, veprat artistike, monedhat, automjetet dhe të ngjashme;
  - 1.4. çfarëdo pasurie të menaxhuesit të mjeteve apo të mbajtësit të fondit ose të anëtarit të Bordit drejtues të Fondit Pensional apo të cilit do personi të ndërlidhur të menaxhuesit të mjeteve, mbajtësit ose anëtarit të bordit drejtues të Fondit pensional;
  - 1.5. letrat me vlerë të emetuara nga palët e ndërlidhura sipas nenit 2 të kësaj rregullore.
  - 1.6. fondet tjera që i përcakton BQK-ja.

## **Neni 6**

### **Dispozitat përfundimtare**

1. Nëse mjetet pensionale të investuara nuk janë në pajtim me kërkesat e Ligjit për Fondet Pensionale dhe kësaj rregulloreje si pasojë e: a) ndryshimit të çmimeve në treg që paraqet bazën për vlerësimin e fondit; b) ndryshimit të tarifave të valutave të huaja të këmbimit; c) ndryshimit në marrëdhëniet organizative ose ekonomike që janë bërë ndërmjet personave në të cilët investohen mjetet dhe d) çfarëdo rrethane tjetër e cila është jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të menaxhuesit të mjeteve pensionale, atëherë Menaxhuesi i Mjeteve të Pensionit duhet të marrë masa për t'ia përshtatur veprimet e investimit kërkesave të caktuara me Ligjin për Fondet Pensionale dhe kësaj rregullore, duke pasur

kujdes që të plotësohen edhe kërkesat tjera të Ligji për Fondet Pensionale dhe kësaj rregullore për rritjen maksimale të fitimit dhe ruajtjen e fondit pensional.

2. Përshatja e veprimeve të investimit ndaj kërkesave të përcaktuara me Ligjin për Fondet Pensionale dhe me këtë rregullore duhet të kryhet më së voni gjashtë (6) muaj pas datës në të cilën ndodh shkelja ose në datën kur në bazë të vlerësimit të fondit konstatohet se ka pasur shkelje.

#### **Neni 7**

##### **Zbatimi dhe masat përmirësuese**

Shkeljet e dispozitave të kësaj Rregulloreje do të jenë subjekt i masave të parashikuara me Ligjin për Fondet Pensionale.

#### **Neni 8**

##### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore do të shfuqizohet Rregulla 9 mbi Investimet e Mjeteve të Pensioneve të datës 25 korrik 2002.

#### **Neni 9**

##### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me datë 31 mars 2017.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Bedri Peci